USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

INFORMATORI

Iniciativa "Rinia, e ardhmja" në Istog

Të vendosësh për drejtimin tënd se çka do të bëhesh në të ardhmen natyrisht që është një nga preokupimet më të mëdha për të rinjtë në Kosovë, përfshirë edhe të rinjtë e komunës së Istogut.



Për të rinjtë e Istogut, shkolla e mesme e lartë profesionale nuk ka qenë pothuajse asnjëherë prioritet, pasi që thuajse çdo nxënës si orientim parësor ka gjimnazin. Kjo, edhe për faktin e ndikimit të familjes dhe rrethit shoqëror, por një rol mjaft të madh e luan edhe mungesa e informimit të të rinjve për drejtimet që ofrohen në shkolla profesionale. Në ditët e sotme duke ndjekur tregun e punës, përzgjedhja e një profesioni në shkolla profesionale do të lehtësonte edhe punësimin e të rinjëve.

Shkolla profesionale ofron një numër të larmishëm të profesioneve, të cilat janë të nevojshme në tregun e punës në gjithë Kosovën.

Drejtimet që ofrohen nga **Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale "Mithat Frashëri" në Gurrakoc** të komunës së Istogut janë:

- **MAKINERI**
- **ELEKTROTEKNIKË**
- **EKONOMI**
- **NDËRTIMTARI**
- **MJEKËSI**

Këto degë ndahen më tej në profile të caktuara.

Makineri

- Dirigjues/e kompjuterik/e i makinave
- Operator/e prodhimi
- Metalpunues/e
- Automekanik/e
- Instalues/e i/e ngrohjes së klimatizimit dhe ujit

Elektroteknikë

- Informatikë
- Energjetikë
- Instalues/e elektrik/e

Ekonomi

- Banka dhe sigurime

Mjekësi

- Bashkëpunëtor/e i/e Infermierisë

Iniciativa "Rinia, e ardhmja" në Istog mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.